



EXPORT

Platforma Kombëtare për Fuqizimin e Eksporteve Shqiptare

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) do të organizojë më 28 janar 2026 aktivitetin EksportON 2026, një platformë kombëtare e dedikuar forcimit të eksporteve shqiptare dhe rritjes së konkurrueshmërisë së tyre në tregjet ndërkombëtare.

EksportON 2026 bashkon eksportuesit shqiptarë me të gjithë ekosistemin që mbështet eksportet, duke përfshirë institucionet publike, partnerët financiarë, ekspertët e certifikimit, logjistikës dhe përfaqësues të sektorëve kyç të ekonomisë. Aktiviteti synon të krijojë mundësi konkrete për shkëmbim informacioni, rritje kapacitetesh dhe ndërtim partneritetesh tregtare.

Gjatë aktivitetit, eksportuesit do të kenë akses të drejtpërdrejtë në njohuri praktike mbi tregjet e huaja, standardet dhe certifikimet ndërkombëtare si dhe instrumentet e financimit.

Në fokus do të jenë diskutimet mbi problematikat që përballen bizneset eksportuese, si dhe identifikimi i zgjidhjeve konkrete për kapërcimin e tyre.

Në thelb, ky aktivitet kontribuon në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare dhe në promovimin e markës "Made in Albania" në tregjet ndërkombëtare, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Takim biznesi Shqipëri–Greqi për forcimin e bashkëpunimit ekonomik

U organizua në Greqi një takim biznesi me përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe sipërmarrës grekë, në praninë e Ministres për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Elisa Spiropali, dhe Drejtoreshës së Përgjithshme të AIDA-s, znj. Laura Saro. Aktiviteti u fokusua në forcimin e bashkëpunimit ekonomik dypalësh dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime.

Takimi, i organizuar nga Delphi Economic Forum dhe Ambasada e Shqipërisë në Greqi, evidentoi interes të lartë për investime në sektorë si energjia, turizmi dhe ndërtimi. U theksua bashkëpunimi i vazhdueshëm mes AIDA-s dhe homologëve grekë, Enterprise Greece, si dhe u prezantuan iniciativa konkrete për thellimin e partneritetit.

Si hap i radhës, u konfirmua pjesëmarrja e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar Food Expo në muajin mars, ku një delegacion biznesesh shqiptare do të eksplorojë mundësi bashkëpunimi në fushën e produkteve ushqimore dhe import-eksportit.



AIDA pjesë e Forumit të biznesit Shqipëri–Egjypt–Thellimi i partneritetit ekonomik

AIDA mori pjesë në Forumin dyditor të Biznesit Shqipëri–Egjypt, i zhvilluar në Tiranë më 12–14 dhjetor 2025, i cili synoi forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e partneriteteve strategjike mes dy vendeve.

Forumi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë qeveritarë nga Shqipëria dhe Egjipti, si dhe të institucioneve publike dhe komunitetit të biznesit. Diskutimet u përqendruan në rritjen e shkëmbimeve tregtare, investimeve të ndërsjella dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në sektorë prioritarë si energjia, turizmi, bujqësia, teknologjia dhe punësimi.

Një moment kyç i aktivitetit ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AIDA-s dhe Autoritetit të Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Egjiptit (GAFI), i cili synon thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit në të dy vendet.

Në aktivitet morën pjesë gjithashtu Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Enkelejd Musabelliu, dhe Zëvendësministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Olta Manjani, së bashku me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe komunitetit të biznesit nga të dy vendet.

Forumi Shqipëri–Egjypt shërbeu si një platformë e rëndësishme për forcimin e dialogut institucional dhe ekonomik, duke hedhur bazat për bashkëpunim afatgjatë dhe iniciativa konkrete në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes ekonomike të përbashkët.



AIDA pjesë e “Tirana Economic Forum”

AIDA mori pjesë në Tirana Economic Forum, i cili mbledhi liderë politikë, përfaqësues të biznesit dhe akademikë për të diskutuar sfidat dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe rajonit. Në fjalën hapëse, Kryeministri z. Edi Rama theksoi progresin e Shqipërisë drejt integritimit europian dhe ftoi investorët e huaj të shfrytëzojnë momentin aktual, duke nënvizuar objektivin e anëtarësimit në BE deri në vitin 2030.

Gjatë forumit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, prezantoi transformimin ekonomik të vendit, duke vënë në fokus digjitalizimin, rritjen e produktivitetit, forcimin e sektorit privat dhe stabilitetin makroekonomik.

Në kuadër të forumit u zhvillua paneli “Albania’s Investment Pulse: How Can Albania Attract Quality Investment”, ku mori pjesë edhe Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro e cila theksoi rolin e AIDA-s në promovimin e investimeve dhe rëndësinë e partneriteteve, infrastrukturës cilësore dhe reformave të qëndrueshme si elementë kyç për rritjen e konkurrueshmërisë dhe besimit të investorëve në Shqipëri.



AIDA mbyll sezonin e dytë të “Investor Support Days”



USA Investors Support Day – Shqipëria synon rritjen e investimeve amerikane

Në vijim të nismës “Investor Support Days 2025”, AIDA zhvilloi takimin e dedikuar për investorët amerikanë, në bashkëpunim me Dhomën Amerikane të Tregtisë (AmCham).

Tryeza bashkoi përfaqësues të institucioneve dhe bizneseve amerikane, të cilët diskutuan mbi mundësitë e reja të investimeve në sektorë strategjikë si energjia, turizmi, teknologjia dhe shërbimet profesionale. U theksua gjithashtu potenciali i tregut shqiptar, procedurat e thjeshtuara për biznesin dhe shërbimet 100% online.

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, nënvizoi rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm me sektorin privat dhe angazhimin e AIDA-s për adresimin e çështjeve të ngritura nga investorët.

Zv. Ministri i Financave, z. Andi Memeti, evidentoi avantazhet konkurruese të Shqipërisë, përfshirë harmonizimin e legjisllacionit me BE-në deri në vitin 2027, stabilitetin ekonomik dhe mbështetjen nga Growth Plan i Ballkanit Perëndimor.

Përfaqësuesit e bizneseve amerikane sollën rekomandime për përmirësimin e klimës së investimeve: harmonizimin ligjor me BE-në, rritjen e transparencës, konsultime më efektive publike, luftën kundër korrupsionit dhe modernizimin e sistemit të regjistrimit të bizneseve.

Takimi u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit me rreth 254 kompanitë amerikane që operojnë në vend dhe krijimi i një mjedisi edhe më të favorshëm për investime të reja.



AIDA mirëpriti Shoqatën e Profesionistëve të Lirë të Athinës

AIDA zhvilloi takimin e parë me Shoqatën e Profesionistëve të Lirë të Athinës, një organizatë e gjerë që përfaqëson mbi 200,000 anëtarë, përfshirë edhe biznese shqiptare që operojnë në Greqi. Takimi u fokusua në forcimin e dialogut dhe krijimin e bazave për bashkëpunim me komunitetin e profesionistëve dhe sipërmarrësve grekë.

Gjatë takimit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s prezantoi shërbimet e agjencisë për investitorët e huaj, si dhe mundësitë e investimit në Shqipëri. Përfaqësuesit e Shoqatës prezantuan aktivitetet dhe fushat e tyre të veprimtarisë, duke theksuar rolin e rëndësishëm që organizata luan në digjitalizim, informim dhe zhvillim biznesi, në funksion të rritjes ekonomike.

Ky është një hap i parë drejt krijimit të një platforme të qëndrueshme komunikimi dhe bashkëpunimi mes profesionistëve grekë dhe institucioneve shqiptare.



AIDA mirëpriti përfaqësues të Enterprise Greece

Në ambientet e AIDA-s, Drejtoresha Ekzekutive, znj. Laura Saro, së bashku me ekipin e Drejtorisë së Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit, mirëpriti z. Dimitris Skalkos, President i Enterprise Greece dhe Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, si dhe znj. Maria Koumoutsakou nga Ambasada e Greqisë.

Takimi riafirmoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes AIDA-s dhe Enterprise Greece, të formalizuar përmes Memorandumit të Mirëkuptimit (MoU), me fokus shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e promovimit të investimeve.

Gjatë diskutimeve u shqyrtuan mundësi të reja bashkëpunimi, rritja e flukseve investuese dhe zhvillimi i projekteve të qëndrueshme, të cilat synojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe nxitjen e rritjes ekonomike rajonale.



AIDA pjesë e Business 2030 Forum – Albania Edition

Më 4 dhjetor 2025, AIDA mori pjesë në Business 2030 Forum – Albania Edition, një aktivitet kombëtar që bashkoi institucione, biznese dhe partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe transformimin e bizneseve deri në vitin 2030.

Në kuadër të forumit, përfaqësuesja e AIDA-s kontribui në panelin "Shqipëria në Skenën Globale: Inovacioni, Investimet dhe Gjenerata e Ardhshme", të organizuar nga UNIDO, ku u diskutua roli i RECP Clubs në forcimin e bashkëpunimit mes sipërmarrjeve shqiptare dhe atyre ndërkombëtare. Fokus i diskutimit ishte te krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm mbështetës, rritja e kapaciteteve të NVM-ve dhe lehtësimi i aksesit të tyre në tregjet e Bashkimit Evropian.

Pjesëmarrja e AIDA-s në forum riafirmoi angazhimin e institucionit për të mbështetur bizneset shqiptare në rritjen e konkurrueshmërisë, nxitjen e inovacionit dhe adoptimin e praktikave të gjelbra, në përputhje me standardet mjedisore dhe tregtare të BE-së.



Histori suksesi- Enofama

Enofama përfaqëson një shembull të suksesshëm të ndërthurjes së traditës shqiptare të vreshtarisë me vizionin për zgjerim në tregjet ndërkombëtare. Me fokus të cilësia dhe identiteti i produktit, kompania ka arritur të pozicionohet gjithnjë e më fort në industrinë e verërave.

Falë mbështetjes së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Enofama ka marrë pjesë në panairë ndërkombëtare, duke krijuar kontakte të reja biznesi, partneritete strategjike dhe duke zgjeruar perspektivat për eksport.

Kjo përkrahje ka kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e pranisë së Enofama-s në tregjet globale dhe në forcimin e markës "Made in Albania", duke e kthyer kompaninë në një histori suksesi dhe një model frymëzues për bizneset shqiptare që synojnë ndërkombëtarizimin.



Forumi i Biznesit Shqipëri-Sllloveni

Më 5 shkurt 2026, AIDA organizon Forumin e Biznesit Shqipëri-Sllloveni në bashkëpunim me SPIRIT Slovenia, Institute for Strategic Solutions – ISR dhe Ambasadën e Republikës së Sllovenisë në Tiranë, në ambientet e Tirana Innovation Hub.

Forumi synon të nxisë bashkëpunimin ekonomik dhe krijimin e partneriteteve të reja mes kompanive shqiptare dhe slllovene, veçanërisht në sektorët e ndërtimit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, industrisë ushqimore dhe të pijeve, inovacioneve në bujqësi dhe turizmit. Aktiviteti ofron mundësi për zgjerimin e rrjetit të biznesit dhe zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Shprehni interesin tuaj në adresën e email-it info@aida.gov.al

Mos e humbisni këtë mundësi për të zgjeruar rrjetin tuaj të biznesit dhe për të krijuar bashkëpunime ndërkombëtare!

Match-Maker Albania – Edicioni II

Më 26 mars 2026 do të zhvillohet Edicioni i Dytë i Match-Maker Albania, një platformë që synon të lidhë biznesin shqiptar me partnerë dhe tregje ndërkombëtare. Pas suksesit të edicionit të parë, eventi rikthehet si një hapësirë gjithëpërfshirëse për dialog, bashkëpunim dhe krijim mundësish konkrete biznesi dhe investimi.

Match-Maker Albania II do të ofrojë takime të strukturuar B2B dhe B2G, panele diskutimi me liderë të industrisë dhe vendimmarrës, si dhe prezantime të sektorëve prioritarë të ekonomisë shqiptare. Aktiviteti synon të nxisë investimet, partneritetet strategjike dhe bashkëpunimet afatgjata, duke promovuar Shqipërinë si një destinacion serioz dhe konkurrues për biznes dhe investime.

Regjistrimet për eventin pritet të hapen së shpejti. Aty ku lidhen idetë, bizneset dhe mundësitë globale!

Pas një edicioni të parë të suksesshëm, Match-Maker Albania rikthehet më i madh, më dinamik dhe më ambicioz se kurrë!

Unlock the Opportunity. Make the Right Match.



AIDA ju fton të merrni pjesë në-“ World of Travel Expo 2026” në Florida

World of Travel Expo 2026 – Orlando, SHBA

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon bizneset e sektorit të turizmit, tregtisë dhe investimeve për mundësinë e pjesëmarrjes në World of Travel Expo 2026, që zhvillohet më 10–12 prill 2026 në Orange County Convention Center, Orlando, Florida, SHBA.

Ky panair është platforma kryesore në Amerikën e Veriut për promovimin e turizmit, tregtisë dhe projekteve investuese. Pjesëmarrësit mund të organizojnë workshop-e dhe aktivitete të dedikuara për prezantimin e destinacioneve, produkteve turistike dhe mundësive të investimeve.

Eventi ofron:

- Takime të drejtpërdrejta me investitorë dhe operatorë turistikë amerikanë dhe ndërkombëtarë;
- Workshop-e dhe prezantime partnerësh;
- Sesione rrjetëzimi dhe evente promovuese;
- Ekspozitë paralel me Central Florida's Largest Home Show, me pjesëmarrje të lartë vizitorësh të interesuar në udhëtime, tregti dhe investime.

Për më shumë detaje rreth regjistrimit, tarifave dhe organizimit të aktiviteteve gjatë Expo-s, ftohen kompanitë shqiptare të interesuara, të vizitojnë faqen zyrtare të eventit: WORLD OF TRAVEL – World of Travel, Trade & Taste EXPO 2025



AIDA ju fton të merrni pjesë në-“ World of Travel Expo 2026” në Florida

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me programin SIPPO, planifikon pjesëmarrjen me stendë të Shqipërisë në BIOFACH 2026, panairin më të madh ndërkombëtar të produkteve organike ushqimore, kozmetike dhe përbërësve natyralë, që zhvillohet më 10–13 shkurt 2026 në Nuremberg, Gjermani.

Stenda shqiptare do të përfaqësohet nga një numër i limituar kompanish që plotësojnë kriteret e përcaktuara, përfshirë posedimin e Certifikatës së Produktit Organik sipas standardeve të BE-së, mbulimin e shpenzimeve për regjistrimin dhe marketingun, njohjen e gjuhës angleze dhe/ose gjermane, si dhe prioritet për kompanitë që nuk kanë marrë pjesë më parë në panair ose ofrojnë produkte me vlerë të shtuar.

Bizneset shqiptare të interesuara ftohen të dërgojnë formularin e profilit të kompanisë të plotësuar në adresën [\[info@aida.gov.al\]](mailto:info@aida.gov.al) (<mailto:info@aida.gov.al>) brenda datës 19 dhjetor 2025.

Për informacion shtesë mbi panairin dhe kriteret e pjesëmarrjes, mund të vizitoni [\[BIOFACH 2026\]](https://www.biofach.de/en) (<https://www.biofach.de/en>) dhe [\[formularin e profilit\]](https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Company-profile-BIOFACH-2026.docx) (<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Company-profile-BIOFACH-2026.docx>).



AIDA ju fton të merrni pjesë në “Kongresin e Parë Ndërkombëtar të Akreditimit Halal”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon bizneset shqiptare për mundësinë e pjesëmarrjes në Kongresin e Parë Ndërkombëtar të Akreditimit Halal, që zhvillohet më 6–8 prill 2026 në Ankara, Turqi, i organizuar nga Halal Accreditation Agency (HAK). Tema e kongresit është: “Hap i rëndësishëm i besimit në infrastrukturën globale të cilësisë Halal: Akreditimi Halal.”

Kongresi bashkon ekspertë ndërkombëtarë, institucione akreditimi dhe përfaqësues biznesi nga e gjithë bota për të diskutuar standardet, tendencat dhe mundësitë në tregun global Halal. Eventit ofron platformë dialogu dhe bashkëpunimi për ekosistemin e vlerësimit të konformitetit Halal, duke u fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare.

Ky aktivitet u mundëson kompanive shqiptare të kuptojnë kërkesat e akreditimit Halal, të zgjerohen në tregje të reja dhe të krijojnë partneritete të reja me institucione akreditimi, organe certifikimi dhe aktorë të zinxhirit global Halal.

Bizneset e interesuara ftohen të regjistrohen dhe të vizitojnë faqen zyrtare të kongresit për detaje mbi programin, afatet dhe organizimin: [Bizneset shqiptare të interesuara ftohen të dërgojnë formularin e profilit të kompanisë të plotësuar në adresën \[info@aida.gov.al\] \(<mailto:info@aida.gov.al>\) brenda datës 19 dhjetor 2025.](https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Company-profile-BIOFACH-2026.docx)

Për informacion shtesë mbi panairin dhe kriteret e pjesëmarrjes, mund të vizitoni [\[BIOFACH 2026\]](https://www.biofach.de/en) (<https://www.biofach.de/en>) dhe [\[formularin e profilit\]](https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Company-profile-BIOFACH-2026.docx) (<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2025/12/Company-profile-BIOFACH-2026.docx>).



Akses në Financë- AIDA ju informon për thirrjen CULTURE AND CREATIVITY FOR THE WESTERN BALKANS

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: CULTURE AND CREATIVITY FOR THE WESTERN BALKANS Round 4 of Public Open Calls for co-branding and coordinated marketing.

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: https://lnkd.in/dH_KMDV9



AIDA ju fton të merrni pjesë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Kopshtit "Floraart 2026", Zagreb, Kroaci | Maj 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton bizneset, institucionet dhe profesionistët e gjelbërimit, kopshtarisë dhe dizajnit peizazhist të marrin pjesë në edicionin e 60-të të ekspozitës prestigjioze Floraart, një nga eventet më të rëndësishme të kopshtarisë në rajon.

Këtë vit, vëmendja është e përqendruar tek roli jetik i ujit, habitatet ku ai është tejet i pranishëm apo i munguar, dhe ndikimi i tij tek biodiversiteti.

Çfarë ofrohet për pjesëmarrësit shqiptarë?

- Hapësira ekspozimi falas, si në ambiente të hapura ashtu edhe të mbyllura
- Mundësi për të prezantuar një instalacion që përfaqëson një bimë apo element natyror karakteristik të Shqipërisë
- Shkëmbim njohurish me profesionistë, kompani dhe institucione nga e gjithë bota
- Promovim ndërkombëtar i kulturës sonë botanike dhe peizazhistike

Për më shumë informacion dhe për t'u bërë pjesë e aktivitetit, ju lutem kontaktoni në email info@aida.gov.al

Le të prezantojmë së bashku pasurinë bimore shqiptare në një nga skenat më të rëndësishme të artit të gjelbërimit!

